

Pelegrinazh dyditor në vendet e shenjta dhe historike të Kosovës (22-23 maj).



Udhëtimet shpirtërore mbeten ndër përvojat më të veçanta që pasurojnë zemrën dhe shpirtin e njeriut. Me këtë frymë, anëtarë të famullisë sonë zhvilluan një pelegrinazh dyditor në Kosovë, duke vizituar disa nga vendet më të shenjta dhe historike të rajonit.

Kosova, me trashëgiminë e saj të pasur shpirtërore dhe kulturore, ofron një mozaik të rrallë monumentesh fetare e historike, të ruajtura me përkushtim ndër shekuj. Përveç bukurive natyrore mahnitëse që falin qetësi dhe admirim, çdo ndalesë e këtij udhëtimi mbartte me vete histori, besim dhe kujtesë të gjallë të së kaluarës. Ndalesa e parë ishte qyteti historik i Prizrenit, ku historia dhe kultura bashkëjetojnë në harmoni të plotë. Rrugicat karakteristike, arkitektura tradicionale dhe atmosfera e qetë e qytetit krijuan një ndjesi reflektimi dhe afërsie shpirtërore.

Më pas, pelegrinazhi vazhdoi drejt Manastirit të Graçanicës, një nga monumentet më të rëndësishme të trashëgimisë fetare dhe kulturore.

Arkitektura madhështore dhe afresket unike dëshmojnë fuqinë e besimit dhe artit të ruajtur brez pas brezi.

Vizita në Patrikanën e Pejës ishte po ashtu një përvojë mbresëlënëse. Kompleksi i shenjtë, me vlera të jashtëzakonshme historike dhe shpirtërore, që shkëlqen në një peisazh shkëlqenjës.

Por një ndër kujtimet që mbetet më gjatë nga ky udhëtim është vizita te Manastirin e Shën Stefanit në Deçan⁹. Mikpritja e përzemërt nga Atë Petro dhe Atë Amfiloki, përfaqësues i manastirit për vizitorët, i dha pelegrinazhit një dimension të thellë njerëzor dhe shpirtëror. Fjalët e tyre të urta, qetësia e ambientit dhe shenjtëria e vendit krijuan një ndjenjë paqeje, përlësie dhe mirënjohjeje.

Me të drejtë, këto monumente ruhen sot si pasuri botërore të mbrojtura nga UNESCO, duke dëshmuar rëndësinë e tyre universale për kulturën dhe historinë e njerëzimit.

Ky pelegrinazh ishte më shumë se një udhëtim - ishte një përvojë që bashkoi lutjen, reflektimin dhe mirënjohjen, duke lënë gjurmë të thella në zemrën e çdo pjesëmarrësi.

Mirënjohje të gjithëve për pjesëmarrjen në këtë pelegrinazh të bekuar!

Lavdi Perëndisë për gjithçka! AMIN!

[Kisha Orthodhokse “Apostull Pavli dhe Shën Asti”, Durrës](#)